LIGJ
Nr. 63/2018

PËR EUROBONDIN QË DO TË EMETOHET NGA MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE BLERJEN MBRAPSHT (*BUYBACK*) TË NJË PJESE TË EUROBONDIT EKZISTUES, MIRATIMIN E PËRJASHTIMEVE NGA TATIMET E TAKSAT DHE TË PARASHIKIMEVE PËR HEQJEN DORË NGA IMUNITETI NË MARRËVESHJET QË DO TË LIDHEN

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 84, pika 4, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në marrëveshjet, që do të lidhen nga ministri i Financave dhe Ekonomisë për emetimin e instrumentit "Eurobond" dhe blerjen mbrapsht (*buyback*) të një pjese të Eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020, në përputhje me ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe thelbësisht sipas kushteve të përcaktuara në tekstin e tyre, që i bashkëlidhen këtij ligji, të lejohen parashikimet për heqjen dorë nga imuniteti.

Neni 2

Mbajtësit e titujve të Eurobondit, menaxherët bashkëdrejtues dhe menaxheri për blerjen mbrapsht të një pjese të Eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020, sipas përcaktimeve në marrëveshjet bashkëlidhur, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe çdo tatim apo taksë tjetër në Republikën e Shqipërisë, përkatësisht nga të gjitha transaksionet dhe veprimtaritë që lidhen me emetimin, mbajtjen, ruajtjen e tregtimin e Eurobondeve dhe me blerjen mbrapsht të një pjese të Eurobondit ekzistues 450 000 000 (katërqind e pesëdhjetë milionë) euro, që maturohet në vitin 2020.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 20.9.2018